


FACE

3



**FORCOJMË VETËBESIMIN
DHE PUNOJMË SË BASHKU**

Mosha 10 deri 12 vjeç



FACE - Familjet dhe fëmijët në arsim është një projekt i bashkëfinacuar nga Universiteti i Cyrihut për përgatitjen e mësuesve (Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut) dhe nga Departamenti i Financave i Kantonit të Cyrihut, Zvicër.

Libri i punës FACE 1 - Forcojmë vetëbesimin dhe luajmë së bashku. Moshë 4 deri 6 vjeç

Libri i punës FACE 2 - Forcojmë vetëbesimin dhe festojmë së bashku. Moshë 7 deri 9 vjeç

Libri i punës FACE 3 - Forcojmë vetëbesimin dhe punojmë së bashku. Moshë 10 deri 12 vjeç

Autorja: Wiltrud Weidinger

Bashkautorë: Sabrina Marruncheddu, Peter Holzwarth

Grafika dhe Layout: Nadine Hugli

Redaksia: Franziska Agosti

PH IPE - INTERNATIONAL
ZH PROJECTS IN
EDUCATION
ZURICH UNIVERSITY
OF TEACHER
EDUCATION

Publikuar më 2017

Universiteti i Cyrihut për përgatitjen e mësuesve, Qendra IPE.


www.phzh.ch/ipe

FACE

Wiltrud Weidinger

FORCOJMË VETËBESIMIN DHE PUNOJMË SË BASHKU

Mosha 10 deri 12 vjeç




SI TË PUNOHET ME KËTË LIBËR

Mirë se vini tek FACE – Familje dhe fëmijë në arsim

Ky libër ju përket juve. Është një libër pune për të përmirësuar fuqitë dhe vetëbesimin tuaj. Me këtë libër do të punoni në shkollë bashkë me shokët tuaj dhe me mësuesin. Ky libër ka detyra që ju mund t'i zgjidhni vetë si edhe detyra që mund t'i zgjidhni me një shok.

Në librin FACE do të gjeni dy fëmijë, të cilët do të jenë së bashku me ju në këtë libër. Ata ndonjëherë do t'ju tregojnë diçka në një fotografi, ndonjëherë ata do të jenë aty derisa ju punoni.

Ja ku janë:





Çfarë përmban libri?

Në këtë libër do të punoni përmes shtatë njësive mësimore. Në çdo njësi mësimore ka një temë të cilën mësuesi duhet ta bëjë bashkë me ju. Ndonjëherë do të shkruani diçka, ndonjëherë do të vizatoni, ndonjëherë do të diskutoni dhe do të bisedoni në lidhje me diçka, dhe, ndonjëherë do të bëni diçka. Për çdo detyrë ose mund të lexoni se çfarë duhet të bëni ose mund të pyesni mësuesin tuaj.

Në fund të çdo njësie mësimore do të merrni një detyrë shtëpie që mund ta bëni me ndihmën e familjes suaj. Mësuesi do t'ju tregojë se çfarë duhet të bëni.

Në FACE nuk ka "mirë" apo "keq". Nuk ka gabime!

Tash, para se të filloni: shkruani emrin tuaj në kopertinë e librit që ta dini se është i juaji.

E shkruat? Shumë mirë!

Le të fillojmë! Mirë se vini tek FACE – Familje dhe fëmijë në arsim

PËRMBAJTJA

1 Për familjen time dhe për mua Faqe 6–19

1 – Detyra 1	Ky-kjo jam unë	8
1 – Detyra 2	Lulja e forcës	10
1 – Detyra 3	Në kohën time të lirë	12
1 – Detyra 4	Vizato flamurin tënd	14
1 – Detyrë shtëpie 5	Familja ime dhe unë	16
1 – Detyra 6	Paraqes familjen time	18

2 Çfarë mund të bëj unë – çfarë mund të bëjmë ne Faqe 20–33

2 – Detyra 1	Unë jam një kafshë	22
2 – Detyra 2	Gjërat për të cilat jam i zoti	24
2 – Detyra 3	Rrjeti im i merimangës	26
2 – Detyra 4	Aftësitë e mia kanë rrënjë	28
2 – Detyrë shtëpie 5	Aftësitë që lidhen me familjen	30
2 – Detyra 6	Paraqit aftësitë që lidhen me familjen	32

3 Vendet e mia të parapëlqyera Faqe 34–47

3 – Detyra 1	Vendet e mia	36
3 – Detyra 2	Çfarë bëj në vendet e mia	39
3 – Detyra 3	Rindërtoj vendin tim të parapëlqyer 1	42
3 – Detyra 4	Rindërtoj vendin tim të parapëlqyer 2	44
3 – Detyrë shtëpie 5	Fotografia/vizatimi i vendit tim të parapëlqyer	45
3 – Detyra 6	Cili vend është ky?	46

4 Si sillemi me njëri-tjetrin Faqe 48–61

4 – Detyra 1	Gjithçka në rregull! Me të vërtetë?	50
4 – Detyra 2	Si merrem me një grindje	52
4 – Detyra 3	Grindjet tona dhe loja me role	54
4 – Detyra 4	Marrëveshja jonë për rregullat	55
4 – Detyrë shtëpie 5	Rregullat tona në familje – një studim	58
4 – Detyra 6	Krahasoni rregullat tuaja familjare	60

5 Shokët e mi**Faqe 62–73**

5 – Detyra 1	Shoku im është i veçantë	64
5 – Detyra 2	Çfarë mund të bëj me dhe për shokët e mi	66
5 – Detyra 3	Kush është i duhuri për punën?	68
5 – Detyra 4	Modeloj shokun tim dhe e përshkruaj atë	70
5 – Detyrë shtëpie 5	Konturet e trupit të shokut tim	71
5 – Detyra 6	Ti paraqet shokun tënd	72
5 – Detyra 7	Ti më paraqet mua dhe unë paraqes veten	73


6 Ne përgatitim ekspozitën tonë**Faqe 74–83**

6 – Detyra 1	Vendosim bashkë të gjitha pjesët	76
6 – Detyra 2	Etiketojmë të gjitha pjesët	78
6 – Detyra 3	Shkruajmë një ftesë	79
6 – Detyra 4	Praktikojmë vizitën me udhërrëfyes	81
6 – Detyrë shtëpie 5	Ftoji prindërit e tu	83

7 Çfarë kam mësuar – Çfarë kemi mësuar**Faqe 84–93**


7 – Detyra 1	Pyetje dhe përgjigje për veten	86
7 – Detyra 2	Momentet e mia të lumtura dhe të trishtuara	88
7 – Detyra 3	Detyra ime e parapëlqyer	90
7 – Detyra 4	Çmimi im personal	92

Përshtypjet e mësuesit tim	95
Shënime	96



PËR FAMILJEN TIME DHE PËR MUA

1



1 - DETYRA 1

KY-KJO JAM unë



45'

Detyra:

Shkruaj gjërat më të rëndësishme për veten dhe familjen tënde.

Si punon:


Vetëm, dyshe

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Me një shok klase, përshkruaj foton e vajzës dhe të djalit si edhe familjet e tyre. (fq. 6-7).
2. Plotëso fletën e punës dhe vizato familjen dhe veten tënde.
3. Tregoja atë shokut të klasës dhe shpjegoja vizatimin.
4. Lëre librin të hapur mbi tryezë.
5. Ec nëpër klasë dhe shiko vizatimet e të tjerëve.
6. Ktheu tek banka. Çfarë të pëlqen në lidhje me familjen tënde? Çfarë nuk të pëlqen në lidhje me familjen tënde? Plotëso fletën e punës.
7. Tregoja atë shokut të klasës dhe diskutoni punën e njëri-tjetrit.



Ky-kjo jam unë

Emri im është

Unë jam vjeç.

Unë jetoj në

(vendi).

Me:

(mamanë, babanë, motrat, vëllezërit, gjyshërit, qenin, macen etj.)

Vizato veten dhe familjen tënde

Çfarë të pëlqen?

Çfarë do të doje të ndryshoje?

1 - DETYRA 2

LULJA E FORCËS



45'

Detyra:

Shkruaj gjërat që të pëlqejnë lidhur me veten.

Si punon:

Vetëm, punë dyshe


Materiali:

- Libri
- Ngjyrat

Hapat:

1. Shkruaj emrin tënd në mesin e lules.
2. Shkruaj në çdo petal diçka që të pëlqen në lidhje me veten.
3. Ngjyros lulen.
4. Tregoja lulen tënde shokut/shoqes pranë. Shpjegoji se çfarë ke shkruar dhe dëgjo shpjegimin e shokut/shoqes sate për lulen e tij/saj.
5. Më pas merre lulen e shokut/shoqes pranë, ec përreth dhe tregoj tu tjerëve në lidhje me të.





1 - DETYRA 3

NË KOHEN TIME TË LIRË



45'

Detyra:

Trego se çfarë bën në kohën tënde të lirë. Mblidh ide të reja.

Si punon:


Dyshe, vetëm, me të gjithë grupin

Materiali:








- Libri
- Lapsa

Hapat:

1. Shiko fotot. Çfarë aktivitetesth bën jashtë shkollës? Bëji me nga një shenjë.
2. Tregoja shokut pranë dhe krahasoje.
3. Shiko sërish fotot. Çfarë do të doje të bëje? Diskutoje këtë me shokun pranë.
4. Zgjidh diçka që do të doje të bësh. Gjej dikë në klasën tënde, që e bën atë apo do të donte bëjë atë, apo njuh dikë që e bën atë.
5. Diskuto në klasë: A ka gjëra që fëmijët nuk duhet t'i bëjnë?



Shëno se cilat aktivitete bën jashtë shkollës:



1 – DETYRA 4 VIZATO FLAMURIN TËND



Detyra:

Vizato flamurin tënd personal.

Si punon:


Në grup prej 4 personash

Materiali:


- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Shiko në faqen tjetër. Duhet të vizatosh flamurin tënd personal. Mund të përmbajë vizatime, ngjyra, simbole apo forma. Mos shkruaj mbi të.
2. Përdor ngjyrat dhe lapsat e tu për të punuar mbi të.
3. Kur të kesh përfunduar, ulu në një grup prej 4 personash.
4. Shpjegoji simbolin tënd grupit. Dëgjo përshkrimet e simboleve të tjerëve.
5. Nëse keni kohë, a mund të mendoni për një flamur që do ta përfaqësonte grupin? Diskutojeni këtë së bashku. Çfarë do të zgjidhni si flamur për grupin tuaj?



Përshtatur nga: Gollob, R. / Weidinger, W. (2010): Growing up in democracy. Lessons plans for primary level on democratic citizenship and human rights. Council of Europe Publishing, Strasbourg Cedex.



Emri yt:

1 – Detyrë shtëpie 5

Familja ime dhe unë



Detyra:

Gjej fotografi të vetes dhe të familjes sate për t'i treguar në shkollë.

Si punon:

Së bashku me familjen tënde

Materiali:

- Fotografi të familjes.

Hapat:

1. Gjej një apo më shumë fotografi të familjes sate dhe të tuat. Pyet prindërit apo të afërmit.
2. Vendosi ato në një zarf ose ruaji fotografitë në një farë mënyre, sepse do të duhet t'i marrësh me vete në shkollë. Në këtë mënyrë ato nuk do të dëmtohen.
3. Do të duhet të punosh në shkollë me fotografitë. Pra mos harro t'i fusësh ato në çantën e shkollës.



Shënime

1 - DETYRA 6

PARAQES FAMILJEN TIME



70'

Detyra:

Paraqitu shokëve të klasës familjen tënde.

Si punon:

Vetëm, dyshe

Materiali:

- Libri
- Fotografi të familjes
- Letra të holla të bardha
- Ngjitës


Hapat:


1. Hap librin në faqen 9, ku është vizatimi i familjes sate.
2. Në dyshe shikoni fotot që ju ka dhënë mësuesi. Të cilës familjeje janë? Ecni nëpër klasë dhe përpiquni të gjeni vizatimin që përshtatet.
3. Shiko fotografitë dhe bisedo për to me shokun pranë:
 - Kush i përket familjes tënde?
 - Çfarë bëjnë ata në jetë?
 - Çfarë bëni me ta?
4. Tani, vizato familjen tënde të ëndrrave siç është përshkruar në faqen tjetër.
5. Vendose familjen e ëndrrave në dërrasë.



Familja ime e ëndrrave

- Vendos fletën e hollë të bardhë mbi foton e familjes sate dhe vizato konturat.
- Ngjyrose atë dhe krijo familjen tënde të ëndrrave me veshje të reja, me modele të ndryshme flokësh, me një mjedis të ri. Ngjite këtu familjen tënde të ëndrrave. Shëno personat: Kush është kush?





ÇFARË MUND TË BËJ UNË ÇFARË MUND TË BËJMË NE



2 – DETYRA 1

Unë JAM NJË KAFSHË



30'

Detyra:

Përfytyro se cila kafshë do të doje të ishe dhe vizato kafshën.

Si punon:

Vetëm, dyshe

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Shiko foton e madhe të vajzës dhe të djalit (fq. 20–21). Ata janë shokë dhe kanë shokë. Çfarë bën me shokët? Fol për këtë me shokun tënd.
2. Sikur të mund të jesh kafshë për një ditë, cilën kafshë do ta zgjidhje të ishe dhe përse?
3. Shkruaj kafshën dhe arsyet përse e zgjodhe atë.
4. Vizato kafshën.
5. Kur të kesh përfunduar, kthehu tek shoku apo shoqja dhe tregoji atij/asaj se çfarë bëre. Ndoshta don t'i shpjegosh diçka më shumë.



Unë jam një kafshë




Sikur të mund të jesh një kafshë për një ditë, cilën kafshë do ta zgjidhje për të qenë dhe përse?



Përse:



Vizato këtu kafshën!



2 – DETYRA 2

GJËRAT PËR TË CILAT JAM I ZOTI



35'

Detyra:

Gjej se për cilat gjëra je i zoti.

Si punon:


Vetëm, dyshe


Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Bëj ushtrimin në faqen tjetër dhe krahaso atë me shokun tënd pranë.
2. Shkruaj të gjitha gjërat për të cilat je i zoti. Mund edhe t'i vizatosh ato.
3. Kthehu tek shoku pranë dhe krahasoni idetë tuaja. Çfarë thotë ai/ajo? Çfarë mund të thuash në lidhje me idetë e tij/e saj?





2 – Detyra 3

RRJETI IM I MERIMANGËS



40'

Detyra:

Plotëso aftësitë dhe kompetencat e tua në rrjetin e merimangës.

Si punon:

Vetëm, dyshe

Materiali:


- Libri
- Lapsat, ngjyrat

Hapat:

1. Shiko fotot dhe fjalët në faqen tjetër.
2. Mendo se sa i zoti je për secilën aftësi nga këndvështrimi yt. Bëj një kryq (5 = shumë mirë, 4 = mirë, 3 = në rregull, 2 = pak, 1 = aspak)
3. Lidh të gjitha kryqet me një vijë dhe kështu do të bësh rrjetin e merimangës.
4. Tani, shkëmbe librin tënd me të shokut dhe shiko në të tijn apo sajn.
5. Krahaso të dy rrjetet. A janë të njëjtë?
6. Çfarë të befason?
7. Kur të kesh përfunduar, mund të ngjyrosësh fotot.



Rrjeti im i merimangës



2 – DETYRA 4

AFTËSITË E MIA KANË RRËNJË



30'

Detyra:

Kupton prej nga i ke mësuar të gjitha aftësitë tua dhe i krahason ato me të tjerët.

Si punon:

Vetëm dhe dyshe

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Shiko sërish në tullumbacet e tua (fq. 25) dhe në rrjetin e merimangës (fq. 27). Zgjidh 3 aftësi mbi të cilat do të punosh. Nëse nuk je i sigurt kërkoji ndihmë mësuesit.
2. Shkruaj tri aftësitë në maje të pemës (1 në çdo maje peme).
3. Mendo në lidhje me ku, kur dhe nga kush i mësove këto aftësi:
 - Në shkollë? Në shtëpi? Në kuzhinë? Jashtë?
 - Nga babai apo mamaja jote? Nga gjyshërit e tu? Nga motra apo vëllai? Nga xhaxhai/daja apo halla/tezja? Nga mësuesi yt? Nga shokët e tu?
4. Plotëso me detaje çdo aftësi.
5. Kur të kesh përfunduar, ec nëpër klasë dhe krahaso përfundimet e tua të paktën me dy prej shokëve të tu.



Aftësitë e mia kanë rrënjë

Kur?

Kur?

Ku?

Nga kush?

Kur?

Ku?

Nga kush?

Kur?

Ku?

Nga kush?

2 – Detyrë shtëpie 5

Aftësitë që lidhen me familjen



Detyra:

Kryej një intervistë me një prej pjesëtarëve të familjes sate nga i cili ke mësuar një aftësi.

Si punon:

Në shtëpi ose në një vend të qetë

Materiali:

- Libri
- Lapsa

Hapat:

1. Shiko pemën e aftësive në faqen 29. Zgjidh një aftësi (të luash futboll, të këndosh etj.). Nga kush e ke mësuar?
2. Në shtëpi, intervisto këtë person në lidhje me aftësinë. Bëji të gjitha pyetjet në faqen 31.
3. Shkruaj përgjigjet dhe plotëso titullin.
4. Falënderoje personin për intervistën.



Aftësitë që lidhen me familjen

Aftësia ime është:

E mësova atë nga:

1 Ku e mësove këtë aftësi?

2 Çfarë duhet të bësh?

3 Mund ta përshkruash atë?

4 Çfarë të duhet për aftësinë? (mjete, material, përbërës...)

5 Cila është gjëja më e vështirë për këtë aftësi?



2 – DETYRA 6

PARAQIT AFTËSITË QË LIDHEN ME FAMILJEN



40'

Detyra:

U paraqet disa prej shokëve të tu të klasës aftësitë që lidhen me familjen tënde dhe mëson për aftësitë e njerëzve të tjerë.

Si punon:




Në grup dhe në klasë

Materiali:


- Pikturë
- Libri

Hapat:

1. Hap librin në faqen e aftësive që lidhen me familjen.
2. Ec nëpër klasë dhe bisedo me një shok/shoqe klase për aftësitë që lidhen me familjen tënde.
3. Dëgjo aftësitë të cilat t'i paraqet ai/ajo.
4. Bëje këtë me dy shokë të tjerë të klasës.
5. Ti mund të bësh një kuiz jashtë kësaj. Shiko në faqen tjetër. Shoku i klasës mund të të bëjë pyetje dhe ti t'i përgjigjesh. Ai/ajo mund të hamendësojë aftësinë që lidhet me familjen?
6. Ulu sërish dhe paraqit se çfarë ke mësuar nga aftësitë e të tjerëve në klasë.



Mendo çfarë bëj unë!



Po

Jo

Është mamaja, babai, motra, kushërira jote etj.?

A ka aftësia jote lidhje me të gatuarin,
të riparuarit, të vizatuarit, të punuarit me dorë etj.?

A e bën atë brenda?

Të duhet shumë material për atë?

Të duhet dru, metal, pëlhurë, ujë, bojë etj.,
për ta bërë këtë?

Të duhen instrumente të rënda?

Të duhet të lëvizësh shumë, kur e bën këtë?

Rri ulur?


Rri në këmbë?

Të duhet të flasësh që ta bësh këtë?

A bën shumë zhurmë ajo?


etj.





Vendet e mia TË PARAPËLQYERA

3



3 – DETYRA 1

Vendet e mia



45'

Detyra:

Mendo në lidhje me vendet në të cilat shpenzon kohë dhe mblidhi ato. Zgjidh vendet e tua të parapëlqyera.

Si punon:

Vetëm, më pas dyshe

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Shiko vajzën dhe djalin (fq. 34–35) Ku u pëlqen atyre të shpenzojnë kohë? Bisedo për këtë gjë me shokun tënd të klasës.
2. Mendo për vendet në të cilat shpenzon kohën më të madhe. Shkruaj ato në tabelë.
3. Shenjoi përskaj kolonës, ato që janë vendet e tua të parapëlqyera.
4. Tani, zgjidh dy vende të parapëlqyera dhe vizatoji ato (fq. 38).
5. Përse janë këto vendet e tua të parapëlqyera?
6. Tregoju vendet e tua shokut a shoqes së klasës. Bisedo në lidhje me këto pyetje:
 - A zgjodhe të njëjtat vende?
 - Çfarë të pëlqen në vendet e tua?
 - A ka ndryshime?



Vendet e mia

Vendet


Të parapëlqyera?



Mëngjesi



Dreka




Pasditja




Mbrëmja

Vendi i parapëlqyer 1



Arsyeja pse: _____

Vendi i parapëlqyer 2



Arsyeja pse: _____

3 – DETYRA 2

ÇFARË BËJ NË VENDET E MIA



45'

Detyra:

Mendo sërish për vendet e tua të parapëlqyera dhe se çfarë bën në këto vende.

Si punon:


Vetëm, më pas dyshe

Materiali:

- Libri
- Lapsa, lapsa me ngjyra

Hapat:

1. Shiko sërish dy vendet e tua të parapëlqyera (fq. 38). Cilat janë gjërat që bën atje?
2. Qarko foljet e veprimit.
3. Nëse fjala e duhur nuk është aty, shkruaje atë poshtë.
4. Shkruaj të gjitha fjalët që ke zgjedhur në kutitë për çdo vend të parapëlqyer. Bëj një vizatim të vetes, duke bërë diçka atje.
5. Ec përreth me librin tënd. Bisedo për vendet e tua të parapëlqyera të paktën me dy shokë të tjerë të klasës.



Çfarë bëj në vendet e mia

QARKO SE ÇFARË BËN NË VENDET E TUA TË PARAPËLQYERA.

të shkruash

të luash

të mos bësh asgjë

të gatuvash

të fësh

të shohësh TV

të luash futboll

të kërcësh

të lexosh

të riparosh
diçka

të bësh detyrat
e shtëpisë

të vizatosh

të punosh

të relaksohesh

të luash
me celularin

të bësh
diçka

të kërkosh
në internet

të dëgjosh

të bisedosh

të thurrësh

të ndihmosh diçkë

të shikosh fëmijët
e vegjël

të ndihmosh
babanë tënd


të ndihmosh
mamanë tënde

të pikturosh


të qepësh

Fjalët e mia:

Vendi i parapëlqyer **1** - Çfarë bëj



Vendi i parapëlqyer **2** - Çfarë bëj



3 – DETYRA 3

RINDËRTOJ VENDIN TIM TË PARAPËLQYER 1



30'

Detyra:

Bëj një plan për të rindërtuar vendin tënd të parapëlqyer.

Si punon:

Diskuto me të gjithë grupin dhe më pas puno vetëm

Materiali:

- Libri
- Kuti të vjetra këpucësh, letër karton
- Bojëra, ngjyra
- Gërshërë, ngjitëse
- Copë leckë, letër muri, tekstile të vjetra etj.
- Revista të vjetra, gazeta

Hapat:

1. Mendo në lidhje me vendet e tua të parapëlqyera. Duhet t'i rindërtosh ato.
2. Për këtë gjë duhet materiali që vijon: Një kuti (ndoshta një kuti këpucësh apo një kuti tjetër), letër, ngjitës, copë leckë, gërshërë, ngjyra apo bojëra, materiale të tjera që mund t'i përdorësh.
3. Mësuesi do t'i ketë disa nga këto materiale. Nëse ke në shtëpi diçka nga këto që nuk ju duhen, sille në shkollë.
4. Bëj një plan se si do ta rindërtosh vendin tënd të parapëlqyer. Bëj një skicë në faqen tjetër.
5. Nëse nuk ke kuti këpucësh, mund të krijosh një me karton dhe letër.



Rindërtoj vendin tim të parapëlqyer



Kjo është skica e rindërtimit:

Dua të përdor këtë material:

3 – DETYRA 4

RINDËRTOJ VENDIN TIM TË PARAPËLQYER 2



60'

Detyra:

Rindërto vendin tënd të parapëlqyer dhe tregojua atë shokëve të tu.

Si punon:


Vetëm, më pas me të gjithë grupin

Materiali:

- Libri
- Kuti të vjetra këpucësh, karton
- Bojëra, ngjyra
- Gërshërë, ngjitëse
- Copë leckë, letër muri, tekstile të vjetra etj.
- Revista të vjetra, gazeta.
- reviste të vjetra, gazeta

Hapat:

1. Fillo rindërtimin e vendit tënd të parapëlqyer.
2. Merr materialin që të duhet dhe sille atë në tryezën tënde.
3. Kujtohu ta ndash nëse ndonjërit i duhet i njëjti material si i yti.
4. Puno vetë. Kur të kesh përfunduar, shkruaj emrin mbi rindërtimin e vendit tënd të parapëlqyer.
5. Tregoja përfundimin tënd mësuesit.
6. Vëje në bankë për ekspozim para klasës.



3 – Detyrë shtëpie 5

Fotografia/vizatimi i vendit tim të parapëlqyer



Detyra:

Bëj një fotografi dhe/apo vizato një skicë të përafërt të vendit tënd të parapëlqyer.

Si punon:

Vetëm apo me një shok

Materiali:

- Libri
- Celulari apo kamera
- Laps/stilolaps

Hapat:

1. Bëj me celular ose me një kamerë të zakonshme një foto të vendit tënd të parapëlqyer. Po ashtu mund të vizatosh një skicë të përafërt nga natyra në vend të kësaj.
2. Përdore fotografinë në ekran si një model dhe vizato vendin tënd në një copë letre.
3. Kujtohu, ta marrësh atë me vete në shkollë.



3 – DETYRA 6 CILI VEND ËSHTË KY?



30'

Detyra:

Paraqiti shokëve të tu vendin tënd të parapëlqyer.

Si punon:



Vetëm dhe me të gjithë grupin


Materiali:

- Vizatimi i vendit tënd të parapëlqyer
- Lapsa me ngjyra

Hapat:

1. Merr skicën e vendit tënd të parapëlqyer (fq. 45) dhe vizato veten në vendin ku po bën diçka që të pëlqen.
2. Po ashtu mund të shtosh në vizatim gjëra, që nuk janë në fotografi. Po të duash mund edhe të vizatosh vendin tënd të parapëlqyer, të ëndrrave.
3. Kur të kesh përfunduar, mësuesi yt do ta vendosë vizatimin mbi dërrasë.
4. Hidh një sy tek të gjitha fotot. Fol me shokët për vizatimet. Ji i përgatitur t'u përgjigjesh pyetjeve të shokëve.







SI SILLEMI me NJËRI-TJETRIN



4 – DETYRA 1

GJITHÇKA NË RREGULL! ME TË VËRTETË?



45'

Detyra:

Mendo në lidhje me konfliktet dhe problemet në klasën tënde. Ju i zgjidhni ato.

Si punon:

Vetëm, në një grup të vogël dhe me të gjithë klasën

Materiali:

- Libri
- Dërrasë apo një copë e madhe letre
- Shirita të vegjël letre
- Lapsa, ngjitës


Hapat:

1. Shiko fëmijët e ndryshëm (fq. 48 – 49) Cili është problemi këtu? Fol për të me shokun tënd. Rendit idetë.
2. Çfarë lloji problemesh mund të lindin në një klasë? Për shembull.
 - Kur punon me nxënës të tjerë
 - Midis vajzave dhe djemve.
 - Kur gjërat ndahen (hapësira e punës, materiali, lapsi...)
 - Në shoqërim.
3. Shkruaj problemet e tua në copa të vogla letre. Nuk duhet të shkruash emrin tënd.
4. Ngjiti ato në tabelë.
5. Janë dy lloje të ndryshme konfliktesh. Individual dhe i përgjithshëm. Për shembull shumë pak hapësirë në vendin e punës = problem individual, libra të pamjaftueshëm për të gjithë = problem i zakonshëm.
6. Rendit shiritat e letrës në vendet e duhura në tabelë.
7. Cilat probleme mund të zgjidhen lehtësisht dhe si mund të bëhet kjo? Bisedoni bashkë!

PROBLEMET e PËRGJITHSHME



PROBLEMET INDIVIDUALE



4 – DETYRA 2

SI MERREM ME NJË GRINDJE



45'

Detyra:

Mendo dhe diskuto se si mund të sillesh gjatë një grindjeje.

Si punon:

Me të gjithë grupin dhe dyshe

Materiali:

- Libri
- Lapsa

Hapat:

1. Uluni në një rreth të madh.
2. Si silleni gjatë një grindjeje me dikë?
3. Jepni shembuj. Mësuesi i shkruan ato në shirita letrash.
4. Diskutoni mënyrat më të mira për t'u marrë me një grindje.
 - Qëndro i qetë dhe mos e lër veten të ngacmohesh.
 - Mund t'i largohesh një grindjeje.
 - Mund të thuash "jo".
 - Mund të marrësh ndihmë.
5. Mendo situata në të cilat ke përdorur ca nga këto 4 metoda. Regjistroji ato në tabelë në faqen tjetër.
6. Ec nëpër klasë dhe tregoju 4 shokëve të klasës për këto situata.
7. Dëgjo 4 shokët e klasës duke e treguar ata situatat e tyre.



Katër mënyrat e mia për t'u marrë me një grindje


MËNYRAT

SITUATAT E MIA

Të qëndrosh i qetë.




Të largohesh.



Të thuash "Jo".



Të marrësh ndihmë.



Blank space for writing a situation corresponding to the first method: 'Të qëndrosh i qetë.'

Blank space for writing a situation corresponding to the second method: 'Të largohesh.'

Blank space for writing a situation corresponding to the third method: 'Të thuash "Jo".'

Blank space for writing a situation corresponding to the fourth method: 'Të marrësh ndihmë.'

4 - DETYRA 3 GRINDJET TONA DHE LOJA ME ROLE



Detyra:

Në grupe prej katër vetash luani një situatë grindjeje dhe gjeni një mënyrë për ta zgjidhur atë në paqe.

Hapat:

1. Rrini në grup prej katër personash.
2. Në grup diskutoni se çfarë grindjeje doni ta aktroni.
Për shembull:
 - Grindje për një lodër.
 - Grindje në lidhje me kush luan me kë.
 - Grindje për të ndarë gjërat në klasë.
 - Grindje sepse dikush ka thënë diçka të keqe.
 - Grindje sepse dikush nuk do të jetë më edhe më tutje shok.



60'


Si punon:

Në grup prej 4 personash

Materiali:

- Stilolapsa, Lapsa

3. Së bashku, mendoni për një zgjidhje paqësore. A ka këtu vetëm një rrugë?
4. Mendoni se kush do të luajë cilin rol.
5. Ushtroni atë disa herë.
6. Luani situatën para klasës.
7. Nëse keni kohë, mund të bëni një tregim me fotografi (4 fotografi).



4 – DETYRA 4

MARRËVESHJA JONË PËR RREGULLAT



60'

Detyra:

Mendo për rregullat më të rëndësishme dhe hartoni një marrëveshje për klasën.

Si punon:

Vetëm, dyshe dhe me të gjithë grupin

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra
- Shirita të vegjël letre

Hapat:

1. Lexo tekstin në faqen vijuese (fq. 56).
2. Qarko përse mendon që rregullat janë të rëndësishme. Krahasoji ato me ato të shokut të klasës. Jeni dakord?
3. Cilat rregulla do që t'i keni në klasën tënde? Shkruaji ato në shirita të vegjël letre.
4. Ngjiti ato në tabelë.
5. Rrini në rreth.
6. Diskutoni se cilat rregulla doni t'i përfshini në kontratë. Qarko ato që ke zgjedhur.
7. Diskuto pyetjet në vijim:
 - Si na ndihmojnë rregullat për të jetuar dhe punuar së bashku?
 - Përse na duhen ato?
 - A janë të drejta ndaj kujt do rregullat?
 - A ka situata kur rregullat ndryshojnë?
 - Kush duhet t'i bëjë rregullat dhe pse?
 - Çfarë ndodh nëse nuk i ndjekim rregullat?
8. Kopjo në librin tënd (fq. 57) rregullat që keni vendosur. Mësuesi shkruan rregullat në një letër të madhe/poster. Secili nënshkruhet nën to.
9. Posteri është i ekspozuar në klasë.

Rregullat janë të rëndësishme

Kur jetojmë dhe punojmë bashkë na nevojiten rregulla, që të shmangim shumë konflikte dhe probleme. Është e rëndësishme që secili t'i njeh këto rregulla dhe të pajtohet me to. Ka disa arsye pse rregullat janë të rëndësishme. A mund t'i gjesh ato? Qarkoju ato që janë të sakta.

**TË RESPEKTOSH KËDO
NË KLASË.**

**TË JESH NXËNËSI
MË I MIRË.**

**TË LESH KËDO
TË MARRI PJESË.**

**TA BËSH KLASËN
RRËMUJË.**

**TË LESH KËDO
TË BËJË ATË QË DO.**

TË JESH I DREJTË.

**TA BËSH KLASËN
TË RREGULLT / TË PASTËR.**

**TË BËSH MËSUËSIN
TË TË DOJË.**

**TË FITOSH
GJITHMONË LOJËN.**

**TË LESH NXËNËSIT E
DOBËT TË HUMBASIN.**

Rregullat

TË JESH I SJELLSHËM.

**TË KRIJOSH NJË
ATMOSFERË TË MIRË.**

**T'I SHMANGESH
KONFLIKTEVE**

**TË MOS NGACMOSH
ASKËND**

Marrëveshja jonë për rregullat

1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

4 – Detyrë shtëpie 5

Rregullat tona në familje – një studim



Detyra:

Bëj një studim për rregullat më të rëndësishme që ke në familje.

Si punon:


Në shtëpi apo në një vend të qetë

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Shiko tabelën në faqen tjetër.
2. Mund të shikosh një listë me rregulla të ndryshme.
3. Cilat janë rregullat në familjen tënde? Shkruaji ato.
4. Pyet një pjesëtar të familjes nëse nuk je i sigurt.
5. Cilat rregulla i quan të vështira për t'u ndjekur? Shkruaji ato dhe jep një arsye: Pse?
6. Tani, pyet një pjesëtar të familjes: Se cilat rregulla, mendon ai/ajo se janë të vështira për t'u ndjekur prej teje?
7. Sill me vete në shkollë përfundimin e plotësuar.



Rregullat tona në familje - një studim

Mendo se cilat rregulla janë në familjen tuaj.
Kaloje listën poshtë dhe shkruaj rregullat në hapësirat boshe.

RREGULLAT FAMILJARE:

Gatimi, pastrimi, rregullimi,
bërja e pazarit

RREGULLAT PËR TRUPIN:

Larja, larja e dhembëve etj.

RREGULLAT E SJELLJES:

Gjatë të ngrënit, në shtëpi,
në mbremje, në mëngjes.

RREGULLAT E LOJËS:

Në shtëpi, jashtë, të shohësh
TV, të luash me video-lojëra,
të përdorësh celularin.

RREGULLAT E KOHËS:

Kur të jesh në shtëpi,
kur të dalësh jashtë,
kur të shkosh në krevat.

TI: cilat rregulla të duken të vështira për t'i ndjekur? Përse?

PYET NJË ANËTAR TË FAMILJES:

Cilat rregulla mendon ai/a jo se janë të vështira për t'u ndjekur prej teje?

4 – DETYRA 6

KRAHASONI RREGULLAT TUAJA FAMILJARE



40'

Detyra:

Mendoni se përse na duhen rregullat në shtëpi. Në grupe paraqitni në klasë rregullat më të rëndësishme shtëpiake.

Si punon:


Dyshe, punë në grup dhe me të gjithë grupin

Materiali:

- Libri
- Shirita letre
- Stilolapsa

Hapat:


1. Krahaso rregullat e familjes sate (fq. 59) me një shok të klasës.
 - A keni rregulla të ngjashme?
 - Janë ato pak a shumë rregulla të rëndësishme?
2. Në grupin tuaj, shkëmbeni mendime në lidhje me rregullat.
3. Më pas zgjidh dy rregulla dhe diskuto pse ato janë të rëndësishme.
4. Shkruaj ato në shirita letre dhe vendosi në tabelë.
5. Njëri prej jush paraqet dy rregullat dhe arsyet pse i zgjodhi ato.
6. N.q.s. ka kohë diskuto pyetjet në faqen tjetër.







Çfarë nëse ju do t'i bënit
rregullat në familjen tuaj?
Cilat rregulla do të zgjidhnit?





SHOKËT e mi



5 – DETYRA 1

SHOKU IM ËSHTË I VEÇANTË



45'

Detyra:

Mendo se çfarë kuptimi ka shoqëria për ty.

Si punon:


Vetëm, dyshe dhe me të gjithë grupin

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Hidh një sy në fotografinë e madhe të vajzës dhe të djalit (fq. 62–63). Ata janë shokë dhe kanë shokë. Çfarë bën ti me shokë? Fol për këtë me partnerin tënd.
2. Kush është shoku yt? Rendit tri gjëra në fletën e punës që e bëjnë shokun tënd të veçantë. (fq. 65).
3. Me partnerin tënd krahaso se çfarë ke shkruar.
4. Diskuto se çfarë kuptimi ka shoqëria për ty. Ke nevojë për shokë? Pse? Bëj shënime.
5. Pse të duhen shokët? Diskuto në klasë.



Shoku im më i mirë

1

Çfarë është një shok i vërtetë? Çfarë është shoqëria?

2

Shoku im më i mirë.

Rendit tri gjëra që e bëjnë të veçantë shokun tënd.

1.

2.

3.

3

A ka nevojë njeriu për shokë? Përse? Nëse nuk mund të përgjigjesh, bëj një vizatim të vetes dhe të shokut tënd.

5 – Detyra 2

ÇFARË MUND TË BËJ ... me dhe për shokët e mi?



30'

Detyra:

Mblidhni idetë e ndryshme për gjërat që ju mund të bëni me dhe për shokët tuaj.

Si punon:


Vetëm, dyshe

Materiali:

- Libri
- Lapsa

Hapat:

1. Lexo pyetjet në faqen vijuese.
2. Shkruaj përgjigjet.
3. Kur të kesh përfunduar, diskuto përfundimet me shokun tënd. Shoku yt më pas komenton përgjigjet tuaja.
4. Shëno pikat për të cilat keni rënë bashkë dakord me shenjën (✓). Shëno pikat për të cilat nuk keni rënë dakord me një kryq të madh (×).
5. Tani, dëgjo përfundimet e shokut tënd dhe jep komentet për përgjigjet e tij.
6. Nëse mbetet kohë, mund të diskutoni të gjitha pikat për të cilat nuk keni rënë dakord.



Çfarë mund të bëj me dhe për shokët e mi?

3 gjëra që dëshiron t'i bësh
me shokët e tu.

3 gjëra që shokët i pëlqejnë
tek ti.

3 mënyra se si mund
të ndihmosh të tjerët.

3 mënyra se si shokët mund
të të ndihmojnë ty.

5 – Detyra 3

KUSH ËSHTË I DUHURI PËR PUNËN?



30'

Detyra:

Vendos se cili prej shokëve të tu do të ishte i mirë për cilën punë.

Si punon:

Vetëm, dyshe

Materiali:

- Libri
- Lapsa


Hapat:

1. Shiko përmbledhjen e punëve te fluskat (fq. 69).
2. Mendo për të gjithë shokët e klasës.
3. Vendos se cili shok klase do të ishte i zoti për cilën punë.
4. Shkruaj emrat në fluska.
5. Tani mendo për veten. Për cilën punë do të ishe i zoti?
6. Ec nëpër klasë dhe fol me shokët që janë të shënuar në fluskat e tua.
7. Tregoju atyre se cilat punë u keni caktuar atyre. Çfarë thonë ata?



Kush është i duhuri për këtë punë?


... t'i dërgojë një mesazh drejtorit të shkollës.



... të të ndihmojë për të lexuar një tregim.



... të të ndihmojë për të bërë një pikturë.




... të të ndihmojë në një zënkë.



... të të ndihmojë kur të lëndosh veten.

... të të ndihmojë në detyrat e shtëpisë së matematikës.

... të të ndihmojë të fitosh para.



$$9 + 6 = \text{?}$$



5 – DETYRA 4

MODELOJ SHOKUT TIM DHE E PËRSHKRUAJ ATË



60'

Detyra:

Modelo shokun tënd me argjilë/plastelinë. Bëj një përshkrim.

Si punon:


Vetëm, dyshe

Materiali:

- Plastelinë
- Lapsa, lapsa me ngjyra
- Karta të vogla për emërtim dhe për ekspozim

Hapat:

1. Merr një paketë plasteline nga mësuesi dhe ndaje atë me shokun tënd.
2. Duhet të modelosh shokun tënd. Cilin shok do ta zgjedhësh? Si duket ai/ajo?
3. Fillo ta modelosh hap pas hapi.
4. Shkruaj një përshkrim të shkurtër për shokun tënd në një kartë të vogël.
5. Tregoja shokut tënd se çfarë ke bërë (nëse ai/ajo është në të njëjtën klasë) dhe ekspozoje figurën tënde në bankën përballë.



5 – Detyrë shtëpie 5

Konturet e trupit të shokut tim



Detyra:

Bën një konturë të trupit të shokut tënd dhe të vetes.

Si punon:

Punë dyshe

Materiali:

- Dy copa të mëdha letre
- Lapsa, stilolapsa

Hapat:

1. Gjej një shok.
2. Merr një letër të madhe nga mësuesi.
3. Gjej një vend të mirë se ku do të bësh një konturë të trupit.
4. Kërkoji shokut tënd të shtrihet në letër dhe hidh gjurmët e tij me një stilolaps.
5. Shkruaj se çfarë mund të bën shoku me konturën e trupit të tij. P.sh. këmbët = kërcëj, gojë = këndoj etj. Bëji atij pyetje, që t'i kuptosh.
6. Tani është radha jote. Shoku yt vizaton konturet e trupit tënd për ty.
7. Sill me vete në shkollë konturimin e trupit.



5 – DETYRA 6 TI PARAQET SHOKUN TËND



60'

Detyra:

Paraqet konturet e trupit në klasën tënde.

Si punon:




Bashkë me të gjithë klasën

Materiali:

- Konturet e trupit

Hapat:

1. Vendosi konturet e trupit në mur.
2. Ec përreth dhe shiko të gjitha konturet e trupit.
3. Mësuesi juaj do të fillojë lojën kush e gjen: Konturet e kujt janë këto?
4. Kush mund ta bëjë çka? Mund ta gjeni se kush janë të gjithë shokët tuaj të klasës?
5. A e gjetën ata tuajën?



5 – Detyra 7

TI MË PARAQET MUA DHE UNË PARAQES VETEN



60'

Detyra:

Vizato një portret të njërit prej shokëve të klasës. Mund ta ndryshosh portretin.

Si punon:


Dyshe, vetëm, me të gjithë grupin


Materiali:

- Letër
- Lapsa, ngjyra etj.







Hapat:

1. Dyshe: Vizatoni njëri-tjetrin dhe ndieni kënaqësi duke bërë këtë. Mund të mos jetë e përkryer.
2. Jepja portretin shokut tënd.
3. Përshtat portretin tënd nëse ka gjëra që do të doje t'i ndryshosh.
4. Merre portretin e përfunduar, ec përreth dhe tregoj shokëve të klasës.
5. Tregoji personit që të vizatoi, çfarë të pëlqeu? Çfarë ke ndryshuar?





NE PËRGATITIM EKSPOZITËN TONË



6 – Detyra 1

VENDOSIM BASHKË TË GJITHA Pjesët



Detyra:

Mblidh të gjitha gjërat që ke prodhuar dhe përgatite një poster të madh.

Si punon:


Vetëm, punë dyshe

Materiali:

- Libri
- Të gjitha materialet që janë prodhuar: fotografi, figura, kuti
- Lapsa, ngjyra, ngjitës

Hapat:

1. Shiko të gjitha gjërat që ke prodhuar gjatë punës me librin FACE:
 - Vizatimet
 - Fletët e punës: Aftësitë që lidhen me familjen
 - Kutia e vendeve të parapëlqyera
 - Figura plasteline
 - Konturet e trupit
2. Merr një poster të madh apo letër table dhe vendos se çfarë do të ngjitësh në të (përveç figurës dhe kutisë, sigurisht!)
3. Lista ju ndihmon të grumbulloni gjithçka.
4. Pyet shokun se çfarë mendon ai për idenë tënde ose pyet mësuesin tënd.
5. Bëj një postër të këndshëm nga (me) këto.
6. Fillo të ngjisësh gjithçka në poster.



Vendosim së bashku të gjitha pjesët

OBJEKTI	KOLEKSIONI	E BËRË
Fotografi/vizatimi i imi dhe i familjes sime	ekspozim	<input type="radio"/>
Aftësitë e që lidhen me familjen time	shkruaje atë në poster	<input type="radio"/>
Vendi im i parapqëlqyer Ndërtimi (kuti)	ekspozim	<input type="radio"/>
Rregullat e familjes	shkruaje atë në postër	<input type="radio"/>
Loja me role: Tregimi jonë e grindjes	Aktrim	<input type="radio"/>
Shoku im i bërë prej plasteline	ekspozim	<input type="radio"/>
Kontura e trupit të shokut tim	ekspozim	<input type="radio"/>
Portreti	ekspozim	<input type="radio"/>
Vizatime shtesë	ngjis në postër	<input type="radio"/>

6 – Detyra 2 ETIKETOJMË TË GJITHA Pjesët



Detyra:

Përgatit etiketat dhe përshkrimet për të gjitha gjërat e ekspozuara.

Si punon:

Vetëm, punë dyshe

Materiali:

- Të gjitha objektet e grumbulluara dhe produktet
- Lapsa, ngjyra
- Karta të vogla për etiketim

Hapat:

1. Shiko sërish posterin tënd.
2. Merr karta të vogla letre dhe shkruaj etiketa për çdo ekspozim apo objekt që shfaqet në ekspozite.
3. Kërkoji ndihmë një shoku apo mësuesit tënd, nëse ke nevojë.
4. Këtu janë disa shembuj:
 - Kjo është familja ime. Mamaja ime, babai im, motra ime dhe vëllai im
 - Më pëlqen të kaloj kohën me shokun/shoqen time Ja si duket ai/ajo i/e bërë nga plastelina. Kjo është një fotografi e tij/e saj.
 - Këtu mund të shikoni vendet e mia të parapëlqyera. Ato përfshijnë
5. Përpiqu të përdorësh shkrimin më të bukur të dorës.
6. Mund të zbukurosh posterin dhe kartat.
7. Shiko ekspozitën tënde. Të pëlqen ajo?

6 - Detyra 3

SHKRUAJMË NJË FTESË



60'

Detyra:

Bashkë me mësuesin tënd harto një ftesë për prindërit e tu dhe të gjithë familjen.

Si punon:

Me të gjithë grupin, vetëm

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyrat
- Fletë letre (me ngjyra)

Hapat:

1. Për të ftuar prindërit tuaj dhe familjen tuaj, ju duhet një ftesë.
2. Diskutoni bashkë me mësuesin tuaj se çfarë duhet të shkruhet në ftesë:
 - Si do ta quash ekspozitën tënde?
 - Kur do të mbahet?
 - Ku do të mbahet?
 - Sa kohë do të rrijë hapur?
3. Shkruaj në faqen tjetër një version të ftesës.
4. Tregoja atë mësuesit tënd.
5. Tani, merr një copë të re letre dhe shkruaj ftesën tënde shumë me mjeshtëri.
6. Zbukuroje atë.
7. Le ta nënshkruaj mësuesi.
8. Merre me vete në shtëpi dhe jepju atë prindërve dhe familjes sate.



Ftesa ime

6 – DETYRA 4

PRAKTIKOJMË VIZITËN me UDHËRRËFYES



60'

Detyra:

Praktikoni vizitën me udhërrëfyes nëpër ekspozitë bashkë me mësuesin dhe shokun tënd.

Si punon:


Punë dyshe, më pas me të gjithë grupin

Materiali:


- Libri
- Lapsa

Hapat:

1. Rregullo klasën bashkë me mësuesin tënd.
2. Kur të jetë hapur ekspozita, duhet të drejtosh familjen tënde nëpër të. Duhet ta bësh këtë gjë bashkë me një shok.
3. Praktikojë me një shok: Çfarë do të thoni? Ku do të filloni?
4. Bëj shënime se çfarë do të thuash. Përdor faqen në vijim për këtë gjë.
5. Praktikojë atë disa herë.
6. Fto një klasë tjetër në ekspozitën tënde dhe praktikoj vizitën.



Shënime



6 – Detyrë shtëpie 5

Ftoji prindërit e tu



Detyra:

Merr ftesën tënde dhe ftoji prindërit në ekspozitë. Kujtoju atyre se kur dhe ku do të mbahet.

Si punon:


Vetëm


Materiali:

- Ftesa


Hapat:

1. Merr në shtëpi ftesën e bërë vetë dhe jepju atë prindërve të tu.
2. Tregoju atyre që është një ekspozitë në të cilën ata dhe ti keni kontribuar me fotografi, vizatime etj.
3. Kujtoju atyre se kur dhe ku do të mbahet.





ÇFARË KAM MËSUAR
ÇFARË KEMI MËSUAR



7 – DETYRA 1

PYETJE DHE PËRGJIGJE PËR VETEN



Detyra:

Bëhesh i vetëdijshëm për atë që keni punuar.

Si punon:

Vetëm

Materiali:

- Libri
- Lapsa



30'

Hapat:

1. Gjatë muajve të fundit ke menduar shumë për veten.
2. Tani, është koha t'u përgjigjesh disa pyetjeve nëse të kënaqi puna. Kthehu në faqen tjetër dhe gjithmonë shenjo fytyrën që është e saktë për ty.
3. Kur të kesh përfunduar, zgjati qetë librin mësuesit me faqen e hapur.



Pyetje dhe përgjigje për veten



1.	Më pëlqeu të punoj me këtë libër.				
2.	Mësova gjëra të reja.				
3.	Më pëlqeu të punoj me shokët.				
4.	E kuptoja se çfarë duhej të bëja.				
5.	Mund t'i bëj disa gjëra më mirë tani.				
6.	Më pëlqeu kur duhej të vizatoja diçka.				
7.	Më pëlqeu kur duhej të shkruaja diçka.				
8.	Më pëlqeu kur duhej të flisja me të tjerë.				
9.	Mu duk e lehtë të punoja me këtë libër.				
10.	E di se për çfarë jam i zoti.				
11.	E di se çfarë duhet të përmirësoj.				
12.	E di se për çfarë nuk jam i zoti.				
13.	E di se ç'mendojnë të tjerët për mua.				
14.	E di se ku janë pikat e mia të forta.				
15.	E di se si të tjerët i shohin pikat e mia të forta.				
16.	Dua të punoj më shumë me pikat e mia të forta.				
17.	Dua të punoj më shumë me të tjerë.				
18.	Do të doja të kem më shumë ndihmë nga mësuesi.				
19.	Do të doja të kem më shumë ndihmë nga miqtë e mi.				
20.	Do të doja që të punoja më shumë vetë.				

7 – DETYRA 2

MOMENTET E MIA TË LUMTURA DHE TË TRISHTUARA



Detyra:

Ti bëhesh i vetëdijshëm për atë që ke punuar dhe identifikon ngritjet dhe zbritjet e tua.

Si punon:

Vetëm

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra



30'

Hapat:

1. Mendo sërish për punën në liber.
2. Cili ishte momenti yt më i suksesshëm? Çfarë të bëri të lumtur?
3. A kishte ndonjë moment dështimi? Çfarë të bëri të trishtuar?
4. Shkruaj apo vizato këto momente në faqen tjetër.



*Momentet e mia të lumtura
dhe të trishtuara*



7 - DETYRA 3

DETYRA IME E PARAPËLQYER



25'

Detyra:

Ti bëhesh i vetëdijshëm për atë që ke punuar dhe identifikon detyrën tënde të parapëlqyer.

Si punon:


Vetëm, dyshe

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Shiko gjithë librin sërish.
Lexo të gjitha gjërat që ke bërë dhe shiko të gjitha gjërat që ke vizatuar.
2. Çfarë të ka pëlqyer më shumë?
Mund ta shkruash ose ta vizatosh.
3. Kur të kesh përfunduar, tregoja atë shokut tënd pranë.



Detyra ime e parapëlqyer

7 - DETYRA 4 ÇMIMI IM PERSONAL



30'

Detyra:

Përgatit një çmim për diçka që e ke bërë shumë mirë në librin FACE.

Si punon:

Vetëm, dyshe

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Mendo për kohën kur ke punuar me FACE: Për çfarë je krenar? Çfarë bërë mirë?
2. Përgatit një çmim për veten dhe vizatoje atë në faqen tjetër. Plotësoje se çfarë çmimi është.
3. Vizato një çmim për shokët e klasës, për diçka që ata kanë bërë. Paraqitju çmimin shokëve të klasës.
4. Vendos librin në qendër të klasës.
5. Ec përreth dhe vështro çmimet e të tjerëve. Çfarë mendon?



Çmimi im personal

ÇMIMI

Data:

Emri:

Ë mora këtë çmim për:

Nënshkruar: _____



ÇMIMI

Data:

I jap këtë çmim:

Për:


Nënshkruar: _____



IA DOLE!

KE PUNUAR PËRGJATË GJITHË LIBRIT.

Urime!



Shënime

